


- Gjerësia e asfaltuar 6.5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.2 m
- Trotuare 1 x 1.5 m
- Gjerësia e trupit të rruges 9.30 m


Paketa e shtresave është:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm



Nga progresiva 0+275 deri ne progresiven 0+406.85 rruga ka kete seksion tip:





Parametrat e rruges jane:

- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 2 x 0.5 m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure) + 1 x 1.5 m (trotuare variabel)
- Gjeresia e asfaltuar 5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 1 x 1.1.5 m
- Gjeresia e trupit te rruges 7.80 m

Paketa e shtresave eshte:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm




6.Rruga “Thoma Koxhaj 2”

Rruga "Thoma Koxhaj" ka nje gjatesi prej 295.45 m. Kjo rruge lidh rrugen nr 7 me rrugen Alqi Kondi. Kjo rruge eshte totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndricimi dhe gjelberim). Sipas skemes te rretit rrugor ky segment do jete me dy sense drejtimi + vendparkim. Rruga do te trajtohet me profile tip te ndryshem, aty ku eshte krijuar mundesia rruga eshte projektuar me vendparkim nga te dyja anet.

Seksionet tip jane paraqitur me poshte:

Nga progresia 0+000 deri ne progresiven 0+150 rruga ka kete seksion tip:




Parametrat e rruges jane:

- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 1 x 1.5 m (vendparkim) + 2 x 0.5m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure) + 1 x 1.8 m (trotuare)
- Gjeresia e asfaltuar 6.5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m

- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 1 x 1.8 m
- Gjerësia e trupit të rruges 9.60 m


Paketa e shtresave është:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- çakell 30cm



Nga progresiva 0+150 deri në progresivën 0+250 rruga ka këtë seksion tip:





Parametrat e rruges jane:

- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 2 x 1.5 m (vendparkim) + 2 x 0.5m (kunete) +2 x 0.15 m (bordure) + (trotuare ekz)
- Gjeresia e asfaltuar 8 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Gjeresia e trupit te rruges 9.30 m

Paketa e shtresave eshte:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm




Parametrat e rruges jane:


- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 1 x 1.5 (vendparkim) + 2 x 0.5m (kunete) +2 x 0.15 m (bordure) + 1x1.8 m (trotuare)
- Gjeresia e asfaltuar 6.5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 1 x 1.8 m
- Gjeresia e trupit te rruges 9.60 m

Paketa e shtresave eshte:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm



Nga progresiva 0+275deri ne progresiven 0+295.45 rruga ka kete seksion tip:




Parametrat e rruges jane:

- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 2 x 0.5m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure) + 1x1.8 m (trotuare)
- Gjeresia e asfaltuar 5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 1 x 1.8 m
- Gjeresia e trupit te rruges 8.10 m

Paketa e shtresave eshte:


- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm



7.Rruga “nr 9a, 9b”

Rruga "nr 9" është e ndare në dy segmente rruga nr 9a dhe rruga nr 9b. **Rruga nr 9a** ka një gjatësi prej 143.52 m. Kjo rrugë lidh rrugën Thoma Koxhaj me rrugën Alqi Kondi . Kjo rrugë është totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndriçimi dhe gjelbërim). Sipas skemës të rrjetit rrugor ky segment do jetë me dy sense drejtimi + vendparkim. Seksioni tip është paraqitur më poshtë:

Nga progresia 0+000 deri në progresivën 0+143.52 rruga ka këtë seksion tip:



Parametrat e rruges jane:


- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 1 x 1.5 m (vendparkim) + 2 x 0.5m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure) + 1x 1.8 m (trotuare)
- Gjeresia e asfaltuar 6.5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 m
- Trotuare 1 x 1.8 m
- Gjeresia e trupit te rruges 9.60 m

Paketa e shtresave eshte:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm

Rruga nr 9b ka nje gjatesi prej 71.41 m. Kjo rruge eshte rruge lagje lidhese me rrugen Thoma Koxhaj 2. Kjo rruge eshte totalisht e pasistemuar (pa shtresa asfaltike, pa trotuare, pa rrjet inxhinierik, pa rrjet ndricimi dhe gjelberim). Sipas skemes te rrjetit rrugor ky segment do jete me dy sense drejtimi Seksioni tip eshte paraqitur me poshte:

Nga progresia 0+000 deri ne progresiven 0+071.41 rruga ka kete seksion tip:




Parametrat e rruges jane:

- 2 x 2.5 m (korsi kalimi) + 2 x 0.5m (kunete) + 2 x 0.15 m (bordure)
- Gjeresia e asfaltuar 6.5 m me asfaltobeton
- Kunetat 2 x 0.5 m
- Bordure 2 x 0.15 + trotuar ekz
- Gjeresia e trupit te rruges 6.30 m

Paketa e shtresave eshte:

- 3 cm asfaltobeton + Emulsion bituminoz
- 5 cm binder + Emulsion bituminoz
- stabilizant 15cm
- cakell 30cm






Gjate punes projektuese ne rruget e siper permendura u konstatua qe:

-Do te kete prishje ne te dyja anet e rruges ne rrugen “Besim Alla” ,“Thoma Koxhaj 2” ,“Alqi Kondi”-“Luigj Shala”,Rruga nr.7 kryesisht mureve rrethuese te shtepive, te cilat do te rindertoet sipas detajit (te paraqitur meposhte)






-Do të ndërtohet rrjet I kanalizimeve te ujërave të zeza në të gjithë gjatësinë e rrugës per te gjitha rrugët e sipër permenduara, pervec Besim Alles dhe Thoma Koxhaj
 Kolektori do të ndërtohet pergjate aksit te rrugës. Pusetat Kuz ndodhen ne aks te rruges, kurse Kush nga të dyja anët e rrugës do të shërbejnë si pika shkarkimi për objektet ekzistuese dhe për ato që do të ndërtohen në prespektivë. Ndërtimi i pusetave anësore do të evitonte cdo ndërhyrje në rrugën e re të cilat do të dalin si të domosdoshme nga ndërtimet e reja apo dhe atyre ekzistuese. Pusetat do te vendosen ne nje distance prej 50 m larg njera tjetres.

PUSETE TIP D=150cm

PER TUBA Ø 1000-1200mm (THELLESIA ME E MADHE SE 2,5m)



Qyteti i Tiranës kohët e fundit ka pësuar ndryshime të dukshme në drejtim të shtrirjes së ndërtimeve duke ndjekur dy drejtime kryesore të cilat, në funksion te zhvillimit te tyre kanë sjellë probleme në rrjetin e kanalizimeve. Si drejtim i parë është rritja e intensitetit të ndërtimeve në zonat ekzistuese të ndërtimit dhe drejtimi i dytë është zhvillimi i ndërtimeve në zona pothuaj të pa zhvilluara më parë. Të dy rastet sjellin si rezultat rritjen e sasive të ujrave të zeza dhe ujrave të shiut respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit në zonë dhe rritjes së rrjedhës së ujrave të shiut.

Ky bllok, shtrihet në një zonë me rritje të intesitetit të ndërtimeve dhe ka nevojë për rritjen e



kapacitetit të rrjetit të KUZ.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit:

-Eshte marr në konsideratë perespektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë.

-Eshte marr në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues që ka kapacitetin e mjaftueshëm përcjellës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar eshte marr pranë Sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.

-Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës eshte marr në Bashki.

Eshte marr parasysh “Studimi i Planit të Zhvillimit të Sistemit të Kanalizimeve” kryer nga firma “JICA” dhe studimet pjesore të miratuara në zonën në fjalë.

Sasite e ujit që derdhen në sistemin e kanalizimeve.

Për sasitë e ujrave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve janë përdorur të dhënat e rekomanduara në studimin për kanalizimet e qytetit Tiranë nga firma Japoneze si më poshtë:

Qmes dit= 194 l/ditë/banore

Qmax or= 437 l/ditë/banore

Për sasitë e ujrave të shiut jane përdorur të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar.

Siguria Llogaritëse.


Siguria llogaritëse e ujrave të shiut jane llogaritur 25 % për kolektorët kryesore dhe 40 % për kolektorët sekondarë.

Vlera e llogaritjes së shiut eshte marr për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohëzgjatje prej 15 minutash. Intensiteti për Tiranën është 150-170litra/sek/ha e cila del me llogaritje.


Materiali kryesor ndërtimor, për kanalizimin eshte përdorimi i tubave prej politileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose tubacione betoni me gota, pusetat dhe nënobjektet e tjera janë me material betoni të armuar duke eliminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve që ka rezultuar me probleme..

Për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të shiut jane përdorur puseta betoni me zgarë me material





PROFIL TIP K.U.SH 1




Ujësllësi



Në bashkëpunim me Ujësjetës-Kanalizime sh.a. është saktësuar dhe gjëndja e ujësjetës egzistues, projektet që ka kjo ndërmarje, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin egzistues të ujësjetës. Do të pajisen me rrjet të ri ujësjetës vetëm rruga, Rruga nr. 7. Norma e furnizimit është 150 l/ditë/banor. Materialet që do përdoren për tubacionet e ujësjetës janë tuba i brinjëzuar polietileni HDPE-160 për 10 atm që plotësojnë normativat në fuqi, kanë përbërjen kimike dhe aftësinë mbajtëse ndaj presioneve të llogaritura. E njëjta gjë vlen dhe për pajisjet hidraulike dhe aksesoret.

Saraçineskat dhe pajisjet e tjera hidraulike që do të përdoren janë Pn=16 atm (material gize). Për nyjet janë parashikuar puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave janë realizuar sipas kushteve teknike dhe sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Për lidhjet e banesave janë përdorur fashetat duke eliminuar ndertimin e pusetave. Janë përcaktuar në projekt preventiv lidhjet e mundshme mes linjave kryesore të ujësjetës deri tek hyrjet e pallateve.



Ndriçimi rrugor



Në rrugët perimetrale të zonës është lene ai ekzistues për rrugët "Besim Alla" dhe "Thoma Koxhaj", kurse për rrugët e sipër përmendura "Alqi Kondi"- "Luigj Shala" dhe Rruga nr. 7, "Kristofer Kissi" "Vasil Vinjau" Rruga nr 6, Rruga nr 9, Rruga nr 8, Rruga "Thoma Koxhaj 2", Rruga "Zagoria" Rrugica nr 3 është projektuar i ri.

Në rrugë me gjerësi deri në 9m është parashikuar vendosja në njërin krah e shtyllave të reja metalike me lartësi $H=7.8m$ dhe me spesor $\delta=4mm$

Kokat e ndriçuesave janë me gradë të lartë rezistence dhe me reflektor alumini me luçidim të lartë i paoksidueshëm, i cili bën në një masë shumë të lartë pasqyrimin e dritës. Hapja dhe mbyllja e xhamit të ndriçuesit lejon një çmontim të shpejtë gjatë mirëmbajtjes. Llampat e ndriçimit janë projektuar LED me fuqi 150 ëat deri 250 ëat.

Linja është projektuar me trase nëntokësore ku është vendosur tub plastik fleksibël me dy shtresa me

$\varnothing=90mm$ për kalimin e kabllit të furnizimit dhe tub metalik me $\varnothing=110 mm$ për intersektim rruge.

Pusetat janë prej betoni me përmasa brenda përbrenda $40x40x40cm$ me kapak gize. Distanca ndërmjet pusetave është 25 m larg njëra tjetrës dhe janë vendosur mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet e makinave. Panelet e komandimit janë vendosur me komandim sauteri me fotoelementë.


Është parashikuar dalje energjie në puseta të veçanta për zonat e gjelbëra.

Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat egzistuese të zonës. Në këto kabina duhet të instalohen panelet e ndriçimit rrugor të cilat do ushqehen me ura të veçanta nga transformatori egzistues. Në kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë. Është parashikuar tokëzimi i shtyllave të ndriçimit. Është paraqitur edhe skema e furnizimit me energji elektrike për ndriçimin rrugor.

Jane respektuar normat Europiane të performances së ndriçimit EN 13201: Ndriçuesit janë projektuar me kontroll smart në mënyrë që të rregullohet intensiteti i ndriçimit sipas orëve dhe fluksit të përdorimit të rrugës. Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas PD CEN/TR 13201-1:2014. Është përcaktuar performanca e ndriçimit sipas përdoruesve të rrugës (Makina, Bicikleta, Këmbësor). Jane përcaktuar indikatorët e performancës së energjisë 1. treguesi i densitetit të fuqisë metrike (PDI) DP (i matur në $\frac{E}{lx \cdot m^2}$) dhe treguesit vjetor të konsumit të energjisë (AECI) DE (të matur në $\frac{Eh}{m^2}$). Është



percaktuar lloji i rrugës sipas standartit EN 13201 Urbane, Rurale, Parësore, Dytësore, dhe ne kete mënyrë eshte percaktuar edhe lloji dhe intensiteti i ndriçimit. Jetëgjatësia e ndriçuesit Led sipas standartit IEC 62722-2-1. Eshte percaktuar temperatura e ndriçimit sipas standartit nga 2500 deri 5000 Kelvin, në mënyrë që të evitohet efekti I ndotjes(light pollution) jane percaktuar termat e sigurisë, mbrojta nga tensioni, nga lageshtia etj.



Rrjeti Internet-Telefonisë

Do te ndërtohet rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë, sipas standarteve të përcaktuara dhe eshte marrë në konsideratë numri i operatorëve operues në zonë, numri i komunitetit përfutues, si dhe zhvillimi në prespektivë të këtij shërbimi, për një periudhë kohore 10 vjeçare.


Ky rrjet do shtrihet në të gjithë akset rrugore kryesore dhe sekondare si dhe ka ndërlidhje me rrjetin ekzistues në zonat kufizuese rreth bllokut (ajror ose nëntokësore). Rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë do te ndërtohet sipas standarteve të përcaktuara duke marrë në konsideratë :

- Numrin e operatorëve operues në zonën përreth,
- Numrin e komunitetit përfutues
- Zhvillimin në prespektivë të këtij shërbimi për një periudhë kohore 10 vjeçare.

Ne rrugët “Alqi Kondi”- “Luigj Shala” dhe Rruga nr. 7, “Kristofer Kissi” “Vasil Vinjau” Rruga nr 6, Rruga nr 9, Rruga nr 8, Rruga “Thoma Koxhaj 2”, Rruga “Zagoria” Rrugica nr 3 eshte projektuar rrjet i ri.




mureve rrethuese kemi parashikuar trotuare dhe me te gjera. Trotuari do te shtrohet me pllake trotuari, me nenshtrese betoni (6 cm) zhavorr (7 cm) dhe cakell (20 cm) si me poshte:



Pllaka trotuari 6cm
Rere 3cm
Zhavorr 7 cm
Cakell 20 cm

Vende Parkimi Pergjate gjithe bllokut qe kufizohet nga rrugët "Fabrika e Qelqit", "Konferenca e Pezës", "Besim Alla" dhe "Jorgo Panajoti" perkatesisht per rrugët Besim Alla, Thoma Koxhaj, Alqi Kondi-Luigj Shala dhe Rruga nr.7, rruga nr 9, rruga nr 6, rruga Zagoria, jane parashikuar vende te mjaftueshme te parkimit ne ato zona ku gjeresia e rruges na e mundeson.




Elementet e mobilimit urban

Një vëmendje të veçantë në projekt, i është kushtuar edhe elementëve të mobilimit urban që janë propozuar të përdoren në të gjithë bllokun e banimit, si përgjatë rrugëve ashtu edhe në hapësirat urbane, të tilla si: stola, kosha të mbeturinave, vendin e vendosjes së konteinerëve dhe të largimit publik të mbeturinave, zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare si dhe bllokues të mjeteve në trotuare, zgarat për bicikletat, perkatesisht ne rrugët: Besim Alla , Thoma Koxhaj, Alqi Kondi -Luigj Shala dhe Rruga nr.7.

Detaje Stoli

Stol



Sinjalistika ne fazen e projekt zbatimit

Sipas Detyres se Projektimit eshte hartuar planimetria e sinjalistikes me te gjithë tabelat e nevojshme informuese, lajmeruese , urdheruese etj.

TRIKENDESHE: E KUQE REFLEKTUESE
 SFONDI: I ZI
 SIMBOLI: E BARDHE REFLEKTUESE
 TRIANGLE: RED REFLECTIVE
 BACKGROUND: WHITE REFLECTIVE
 SYMBOL: BLACK



SHENJA NDALUESE PROHIBIT SIGN



SHENJAT PER KUFIRIN E SHPEJTESISE DHE NDALIM PARAKALIHIN
 SPEED LIMIT SIGN & OVERTAKE PROHIBIT

RRETHI: E KUQE REFLEKTUESE
 SHENJA: E ZEZE REFLEKTUESE
 CIRCLE: RED REFLECTIVE
 SIGN: BLACK REFLECTIVE



SHIGJETAT TREGUESE TE RRUGES
 ROAD MARKING ARROWS

Shenje e ishujve te trafikut



DHENIE PERPARESIE
 GIVE WAY ROAD SIGN



Vijat e bardha

Ne planimetrine e rruges jane percaktuar dhe panduset ku do te kalojne kembesoret per te pershkruar rrugen nga njera ane ne tjetren. Vijat e bardha jane shoqeruar me sinjalistike perkatese (shenja lajmeruese).



Rruga "Thoma Koxhaj"

Rruga "Thoma Koxhaj" ka nje gjatesi prej 572 m. Kjo rruge lidh rrugen Besim Alla me rrugen Jorgo Panajoti. Kjo rruge eshte ne gjendje te mire por eshte pare e arsyeshme te behet riparimi pjeserisht I asfaltit ne vende te cilat eshte I demtuar. Jane parashikuar riparime te siperfaqeve te trotuareve ekzistues duke pershire bordure dhe kundrabordurat e demtuara. Kunetat ekzistuese jane pjeserisht te demtuara, kuota e kunetes ne disa vende eshte mbi kuoten e asfaltit, duke mos kryer keshtu funksionin mbledhes se ujrave te shiut. Lind nevoja e prishjes se kunetes ekzistuese dhe ndertimit te kunetes beton C 16/20. Eshte vendosur gjithashtu sinjalistike horizontale dhe verttikale si dhe mobilim urban ku perfshihen vendosja e koshave te vegjel pergjate rruges ne largesi rreth 50 m si dhe plotesimi me kosha te medhenj sipas diskutimeve me drejtorine perkatese ne Bashkine e Tiranes.

Persa i perket rrjetit te ujsjellesit, rrjetit KUZ dhe rrjetit elektrik nuk do te trajtohen pasi ekzistuesit jane gjendje te mire.



Aneks (Shpronosimet)

Procesi i shpronosimit percaktohet ne Ligjin 8561, date 22.12.1999. Ky ligj ka ngjashmeri me ligjet e shpronosimit te vendeve evropiane, eshte pergjithesisht ne perputhje me standardet nderkombetare te drejtave te njeriut dhe te mbrojtjes se prones, si dhe garanton nje proces te drejte dhe transparent.

Gjate punimeve ne bllokun "Fabrika e Qelqit", "Konferenca e Pezes", "Besim Alla" dhe "Jorgo Panajoti "qendodhen ne Njësine Administrative Nr.6, rezulton, qe nga trupi I rruges preken si perfaqendertimi dhe toka. Gjurma e rruges kalon mbi objekte banimi, oborre duke prishur keshtu rrethimet ekzistuese te ketyre objekte. Kjo është një zonë me shumë ndërtime, të përfaqësuar me godina 1-2 dhe 5 katëshe dhe disa blloqe pallatesh të reja, per te cilat do te behen shpronosimet, konkretisht per rrugen Alqi Kondi-Luigj Shala dhe Rruga nr.7. Gjurma e rruges eshtep rojektuar sipas standarteve dhe me sa me pak prishje. Ne rastet kur trotuaret e reja ndeshin ne objekte atehere eshte zvogluar gjeresia e trotuarit deri ne madhesi qe te mundesoje ndertimin e rrjetit inxhinierik (elektrike, optike, ujesjellesetj)




Foto 1 Rr. Alqi Kondi-Luigj Shala

Ne foton 1 eshte vendosur gjurma e rruges, si dhe jane evidentuar objektet qe do te prishen. Gjithsej do teprishen rreth 27 objekte 1 dhe 2 kateshe.

Siperfaqja totale e prishjeve eshte 2559.76 m²


Informacioni mbi pronesine e objekteve dhe tokes eshte disi limituar pasi kjo zone administrative ka qene nen juridiksionin e komunes Kashar. Se fundmi kjo zone ka kaluar nen juridiksionin e

bashkise Tirane zona administrative Nr.6.Verehet qe keto prona jane pergjithesishte pa legalizuara.



Legjislacioni Shqiptar Kyc

Tabela I me poshte identifikon pjeset kyce te legjislacionit shqiptarqe jane me rendesi per sigurirnin e te drejtave mbi token e prekur nga projekti. Nje variant I detajuar I kesaj tablele, perفشire te gjitha referencat e akteve ligjore dhe nenligjore paraqitet me poshte.



Emri ne shqip	Numri dhe Referenca e Miratimit	Akte Nenligjore nese ka	Ceshtjet kyce te trajtuara
Kushtetuta e Republikes se Shqiperise	Ligj nr.8417,date 21.10.1998,ndryshuar me Ligj nr.9675,date 13.01.2007 dhe Ligj nr.9904,date 21.04.2008.		Parimet kryesore Kushtetuese ,te drejtat dhe lirite themelore,organizimi i shtetit dhe pavaresia e organeve shteterore,zgjedhjet,hierarkia e ligjeve etj.
Kodi Civil i Republikes se Shqiperise	Ligj nr.7850,date 29.07.1994, ndryshuar me Ligj nr.8536,date 18.10.1999, Ligj nr.03.05.2001 dhe Ligj nr.17/2012,date 16.02.2012.		Te drejtat ligjore te lidhura me pronen e paluajtshme (si pronesia ,servituti, dhe te drejtat e uzufuktit,lenia ne perdorim,etj.) Palet ndervepruese dhe perfituese ,te drejtat e tyre Kontraktuale modalitetet e perfitimit te te drejtave te permendura me lart,dhe detyrimi per regjistrimin e tyre.
Per regjistrimin e pasurive te paluajtshme	Numer 33/2012 miratuar nga Kuvendi me 21.02.2012. Botuar ne fletoren zyrtare nr.34/2012 date 13.04.2012	Nuk ka akoma akte nga Keshilli i Ministrave(KM)	Organizimidhefunksioni miiZyres se RegjistrimittePasurivete Paluajtshme(ZRPP),kushtet dhe procedurat per regjistrimin e pasurivete paluajtshme dhe administrimi i regjistrimit publik te pasurive te paluajtshme.
Per shpronasimet dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te pasurise prone	Ligj nr.8561,date 22.12.1999. Botuarne fletoren zyrtare ne.37,date 25.02.2000.	VKM nr.127,date 23.03.2000 "Per permbajtjen dhe proceduren e kerkesave per shpronasim dhe	Rregullon te drejten e shtetit per te shpronasuar apo per te marre ne perdorim te perkohshem ,ne interesin publik,pronat e

<p>private per interes publik.</p>		<p>perdorim te perkohshem te pronave per interes publik". VKM nr.138 date 23.03.2000 "Per kriteret teknike te vleresimit dhe llogaritjes se kompensimit per pronat e shpronesuara dhe zhvleresuara dhe te drejtat e paleve te treta "Ndryshuar me vendimin nr.662,date 18.12.2002, vendimin nr.872, date 12.12.2007,vendimi nr.136,date 23.02.2011,vendimin nr.563,date 03.08.2011.</p>	<p>subjekteve juridike apo individeve dhe mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te pronareve te shpronesuar.</p>
<p>Per legalizimin ,urbanizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje</p>			<p>Legjislacioni i ndertimeve informale.Kalimi i te drejtave te pronesise mbi ngastren e tokes ku ehste ndertuar objektet do te legalizohet.</p> <p>Urbanizimi i zonave dhe blloqeve te ndertimeve informale dhe integrimi i tyre ne zhvillimin urban te vendit.Procedurat per plotesimin e legjislacionit te ndertimeve informale dhe krijimi i strukturave perkatese per legjislacionin.</p>




Tabela 1. Identifikimi i Legjislacionit Shqiptar Kyc per Shpronisimet dhe Procedurat Ligjore te nevojshme

Parimet kryesore te Legjislacionit Shqiptar lidhur me Shpronisimet

1. Kushtetuta e Shqiperise dhe Ligji per Shpronisimet jane pergjithesisht ne perputhje me parimet e mbrojtjes se te Drejtave te Njeriut qe renditen ne Deklaraten Universale te te Drejtave te Njeriut. Prona private garantohet nga Kushtetuta (Neni 41).
2. Te drejtat mbi pronen, pavaresisht natyres se tyre (pronesi), duhet te jene te regjistruara ne Regjistrin Publik (Kodi Civil).
3. Procesi i shpronisimit percaktohet ne Ligjin 8561, date 22.12.1999. Ky ligj ka ngjashmeri me ligjet e shpronisimit te vendeve evropiane, eshte pergjithesisht ne perputhje me standardet nderkombetare te drejtave te njeriut dhe te mbrojtjes se prones, si dhe garanton nje proces te drejte dhe transparent. Aspektet e tij kryesore jane si me poshte:
 - o Shpronisimi eshte subjekt i interesit publik "ne perputhje me parimet e pergjithshme te se drejtes nderkombetare";
 - o Shpronisimi eshte objekt i "kompensimit te drejte";
 - o Shpronisimi mund te vendoset vetem nga Keshilli i Ministrave bazuar ne aplikimin e agjencise kerkuese apo entit privat aplikues;
 - o Ligji per shpronisimin percakton hapat kryesore te procesit, te cilet jane dhene me shume detaje ne piken 3.5.
4. Nderkohe qe legjislacioni garanton perputhshmeri me kerkesat baze per te Drejtat e Njeriut, zbatimi i tij nuk ka qene gjithmone ne perputhje me keto parime dhe ka pasur raste shpronisimi ku individeve te prekur iu eshte dashur t'i kthehen mekanizmave te ndryshem te huaj te gjykimit per te siguruar mbrojtjen e te drejtave te tyre.
5. Regjistri i Pasurive te Paluajtshme (pra, regjistri ku regjistrohen te gjitha pasurite e paluajtshme dhe transakcionet perkatese) administrohet nga ZRPP-ja, nje subjekt publik dhe juridik ne varesi te Ministrise se Drejtesise. (Ligji per Regjistrimin, Neni 5 dhe 9). Certifikatat e pronesise dhe te drejtat e tjera mbi pronen (pra, te drejtat e uzufuktit, te drejtat e perdorimit, emfiteoza, servituti dhe te tjera te drejta reale) duhet te regjistrohen (Kodi Civil, Neni 193). Transaksionet duhet te regjistrohen me ZRPP-ne brenda 30 diteve nga ekzekutimi i tyre (Ligji per Regjistrimin, Neni 38). Me kerkese te pronarit apo mbajtesit te se drejtes reale, ZRPP-ja leshon certifikaten perkatese (pra, certifikaten e pronesise, certifikaten e uzufuktit, certifikaten e servitutit, etj). Data e leshimit te certifikates pasqyrohet ne dokumentacionin e regjistruar te pronesise. (neni 32).

6. Kontratat e qirase financiare (leasing) per periudha me te gjata se nente vjet duhet te regjistrohen ne ZRPP. Kontrata duhet te perpilohet nga nje noter (Kodi Civil, Neni 197). Mund te regjistrohen gjithashtu edhe kontratat noteriale te qirase financiare per periudha me te gjata se nje vit. Kur vetem nje pjese e prones eshte objekt i qirase financiare, prona duhet te ndahet ne menyre te pershtatshme dhe te gjitha shenimet mbi qirane financiare duhet te regjistrohen ne regjistrin e prones per pjesen ne fjale (Ligji per Regjistrimin, Neni 51).
7. Regjistrimi i nje certifikate pronesie te perfituar nga ekzekutimi i nje marreveshjeje shit-blerje behet ne momentin e depozitimit te marreveshjes se shit-blerjes (qe duhet te jete ne formatin e nje dokumenti noterial).
8. Kur certifikata e pronesise perfitohet me ligj, vendim te prere te nje gjykate apo nga nje akt administrativ, qe perfshin edhe shpronесimin, regjistruesi pasqyron, bazuar ne keto akte, shtetin ose individin qe ka perfituar pronesine e sendit te paluajtshem si pronar (Ligji per Regjistrimin, Neni 42 dhe 45).
9. Ne rastin kur procesi i regjistrimit behet per nje objekt qe eshte legalizuar, regjistruesi kryen regjistrimin e objektit te legalizuar menjehere pas marjes se lejes se legalizimit dhe dokumenteve shoqeruese te percaktuara ne Ligjin 9482/2006 nga ALUIZNI.

Hapat e Shpronесimit

Me poshte tregohen hapat kyc qe ndermerren per procesin e shpronесimit ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

- IDENTIFIKIMI I PRONAREVE PER SHPRONESIM
 - Lista e Pronareve
 - DokumentacionPronesie (Certifikate, Karte, Harte Treguese)
- VLERESIMI FINANCIAR
 - Percaktimi I vleresimit financiar perkates llogaritur per secilen prone
 - Percaktimi I vleresimit financiar perkates llogaritur per secilin aset
- NJOFTIMI I PRONAREVE TE PREKUR NGA SHPRONESIMI
 - Njoftimi drejteperdrejte me poste rekomande
 - Njoftim perms afishimit ne komunen/bashkikueshte prona shpronесimit
 - Publikimi ne fletoren zyrtare

- SHQYRTIMI I PRETENDIMEVE NGA PRONARET
 - Paraqitja nga pronaret e prekur prej shpronësimeve pretendimet e tyre dhe dokumentacioni perkates.
 - Shqyrtim I pretendimeve te tyre duke perlllogarituvlerenfinanciare.
- PARAQITJA E PROPOZIM APLIKIMIT NE KESHILLIN E MINISTRAVE
 - Paraqitja e propozim aplikimit.
 - Miratimi ose hedhja poshte e propozim aplikimit nga Keshilli I Ministrave
- Vleresimi Financiar do te behet ne baze te kategorive te tokave .Ne rastin tone kemi:
- TOKE E NDERTUESHME
 - Vlera e tokes se ndikuar nga procedurat e shpronësimit percaktohet (ne Lek/m²) nga Vendimet e Keshillit te Ministrave (VKM) qe miratojne listen e vlerave te references te vendosura ne perputhje me Ligjin Kthimit dhe Kompensimit te Pronave.Ne rastet kur nuk ka nje cmim te percaktuar per zona te vecanta ,ne zbatimte VKM-se vlera e tokes duhet te perlllogaritet bazuar ne vleren mesatare te cmimeve te shitjes gjate tre muajve te fundit,sic edhe tregohet nga Regjistrii ZRPP-se.Duhet te nxirret nje deklarate e vecante nga ZRPP-ja (e nenshkruar nga drejtuesi vendor i ZRPP-se) per t'u siguruar mbi kontratat e fundit te shitjes dhe cmimet e rena dakord ne to.Nese ZRPP-ja e rajonit te ndikuar nga shpronësimi nuk ka te dhena mbi vleren e tokes ,vleresimi behet bazuar ne nje krahasim te vlerave te shitjeve dhe blerjeve ne zona te tjera ,sipas kriterëve te meposhtme:
 - Karakteristikat e zones (praturistike,urbane,sub urbane ,rurale);
 - Aftesia inxhinierike e tokes per te mbeshtetur ndertimet.
- NDERTESA BANIMI
 - Vleresimi I ndertesave te banimit perlllogaritet bazuar ne vlerat mesatare te cmimeve te shitjes te percaktuara nga ZRPP-ja(si edhe per token e ndertueshme).Kur treguesit e cmimeve te shitjeve nuk mundesohen ,vleresimi bazohet ne metoden e kosos se ndertimit duke perdorursi reference cmimet e perdorura nga Enti Kombetar i Banesave.

LISTA E SHPRONESIMEVE

EMERTIM I OBJEKTIT : STUDIM - PROJEKTIM NDERTIMI I RRUGES-BLLOKU "FABRIKA E QELQIT", "KOEFERENCA E PEZES", "BESIM ALLA" DHE "JORGJ PANAJOT"					
Nr	Z.A	Nr.pas	Qyteti	Emri Atesia Mbiemri	Sip e matur (m2)
1	S 1		Tirane	I paidentifikuar	72.78
2	S 2		Tirane	I paidentifikuar	28.00
3	S 3		Tirane	I paidentifikuar	106.63
4	S 4		Tirane	I paidentifikuar	41.72
5	S 5		Tirane	I paidentifikuar	116.69
6	S 6		Tirane	I paidentifikuar	41.72
7	S 7		Tirane	I paidentifikuar	148.63
8	S 8		Tirane	I paidentifikuar	108.10
9	S 9		Tirane	I paidentifikuar	30.59
10	S 10		Tirane	I paidentifikuar	108.21
11	S 11		Tirane	I paidentifikuar	20.81
12	S 12		Tirane	I paidentifikuar	22.72
13	S 13		Tirane	I paidentifikuar	159.06
14	S 14		Tirane	I paidentifikuar	270.99
15	S 15		Tirane	I paidentifikuar	185.12
16	S 16		Tirane	I paidentifikuar	30.32
17	S 17		Tirane	I paidentifikuar	124.33
18	S 18		Tirane	I paidentifikuar	130.99
19	S 19		Tirane	I paidentifikuar	272.76
20	S 20		Tirane	I paidentifikuar	78.27
21	S 21		Tirane	I paidentifikuar	93.18
22	S 22		Tirane	I paidentifikuar	193.81
23	S 23		Tirane	I paidentifikuar	108.37
24	S 24		Tirane	I paidentifikuar	66.66
25	S 25		Tirane	I paidentifikuar	32.83
26	S 26		Tirane	I paidentifikuar	63.53
27	S 27		Tirane	I paidentifikuar	39.04
				Total	2559.76

